


**PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR
ARSIMIN PARASHKOLLOR
*BASHKIA KORÇË***



Korce 2024

Përmbajtja

1. Hyrje	Error! Bookmark not defined.
1.1 Qëllimi	Error! Bookmark not defined.
1.3 Shtrirja	Error! Bookmark not defined.
1.4 Vizioni	Error! Bookmark not defined.
1.5 Misioni	Error! Bookmark not defined.
1.6 Objektivat	Error! Bookmark not defined.
1.7 Përgjegjësitë	Error! Bookmark not defined.
2. Procesi i Menaxhimit- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	Error! Bookmark not defined.
2.1 Qëllimi	Error! Bookmark not defined.
2.2 Objektiva të përgjithshëm	Error! Bookmark not defined.
2.3 Regjistrimi I fëmijëve	Error! Bookmark not defined.
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	Error! Bookmark not defined.
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor	Error! Bookmark not defined.
2.4.1 Këshilli i Prindërve	Error! Bookmark not defined.
2.4.2 Bordi i Kopshtit	Error! Bookmark not defined.
2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Error! Bookmark not defined.
3. Proceset Kryesore- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	Error! Bookmark not defined.
3.1 Qëllimi	Error! Bookmark not defined.
3.2 Objektiva të përgjithshëm	Error! Bookmark not defined.
3.3 Përfshirja sociale	Error! Bookmark not defined.
3.3.1 Koncepti i përfshirjes sociale	Error! Bookmark not defined.
3.3.2 Identifikimi i nevojave për përfshirje sociale	Error! Bookmark not defined.
3.3.3 Ndihma e përditshme	Error! Bookmark not defined.
3.4 Mbrojtja e fëmijëve	Error! Bookmark not defined.
3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës	Error! Bookmark not defined.
3.5 Fëmijët me aftësi ndryshe	68
3.5.1 Adresimi i prindërve	68
3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë	72
3.5.3 Ndihma e përditshme	76

<u>4. Proceset Mbështetëse- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit</u>	77
<u>4.1 Qëllimi</u>	77
<u>4.2 Objektiva të përgjithshëm</u>	77
<u>4.3 Burimet Njerëzore</u>	77
<u>4.3.1 Rekrutimi i stafit</u>	77
<u>4.3.2 Trajnimi i stafit</u>	81
<u>4.4 Menaxhimi i godinave</u>	87
<u>4.4.1 Rikonstrukcioni i objekteve</u>	87
<u>4.5 Materialet</u>	96
<u>4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale</u>	101
<u>4.5.2 Prokurimi i materialeve</u>	107
<u>4.6.1 Transporti dhe ruajtja e ushqimit</u>	110
<u>5. Buxheti</u>	111

1. Hyrje

Në Shqipëri në vazhden e ndryshimeve politike, në 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat u përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë kuadër për shkak të decentralizimit Bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t'ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike.

Ndërkohë në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për arsimin, Bashkisë i kaloi në juridiksionin e saj çdo çështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në këtë kuadër Bashkia Korçë harton planin strategjik, në kuadër të përmirësimit të shërbimit.

1.1 Qëllimi

Qëllimi i këtij plani është vazhdimi i implementimit të platformës strategjike dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit parashkollor, i cili konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Korçë.

Plani ka një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Korçë për përmirësimin në mënyrë të ndjeshme të të gjitha proceseve që lidhen me arsimin parashkollor:

- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshteve, me qëllim përsimërimin e shërbimit në kopshtet e Bashkisë, si në godina me vete dhe ato brenda shkollave të cilat kanë nevojë për rikonstrukcion;
- Forcimi i strukturës për AP dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit 2024-2026;
- Përmirësimi i shërbimit në kopshte nën kornizën e objektivave të Bashkisë së Korçës si Qytet Miqësor i Fëmijëve.
- Funkionimi i databazës për menaxhimin e strukturave të Arsimit parashkollor, sipas së cilës të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga autoritetet dhe administrata vendore si dhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të rritur standardin e shërbimit;

1.3 Shtrirja

Plani synon ne vijimësi të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Korçës. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Personi Përgjegjës për Arsimin Parashkollor, pranë Bashkisë Korçë.

1.4 Vizioni

Arsim gjithëpërfshirës për çdo fëmijë të territorit të Bashkisë së Korçës.

1.5 Misioni

Fuqizimi dhe prioritizimi i arsimit parashkollor, si çelësi kryesor i zhvillimit të suksesshëm të brezave të ardhshëm.

1.6 Objektivat

- Fuqizimi i sektorit të Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë Korçë;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet zbatimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit në qytet dhe ngritja dhe fuqizimi i tyre në NJA. (Bordi, Këshilli i prindërve, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit);
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me aftësi ndryshe dhe në nevojë për përfshirje sociale.

1.7 Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:
 - Personi përgjegjës për arsimin parashkollor, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
 - Personi përgjegjës për Njësinë e Shërbimit Social.
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtues kopshti;
 - Mësues kopshti;
 - Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

- Drejtoria e Kujdesit Social
 - Drejtoria e Kontrollit të Territorit
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse
 - Drejtoria e të ardhurave
 - Universiteti “Fan S. Noli”
 - NSHMAÇ
3. Monitorues/vlerësues i planit:
- Kryetari i Bashkisë;
 - Këshilli i Bashkisë.

2. Procesi i Menaxhimit- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimit parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë, etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

2.2 Objektiva të përgjithshëm

Planifikim, zbatim, monitorim dhe kontroll efikas i shërbimit të kopshtit, në kuadër të përmirësimit të cilësisë në Arsimin Parashkollor.

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

Informacion i përgjithshëm

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Korçë është **1526** prej të cilëve **753** janë vajza. Numri i vajzave të regjistruara në kopshtet publike në total rezulton të jetë i barabartë me numrin e djemve të regjistruar.

Bashkia Korçë ka kapacitetet akomodues për **2245** fëmijë në kopshtet publike, për të tre grupet e fëmijëve (grupi i parë, grupi i dytë dhe grupi i tretë). Siç vihet re nga të dhënat e mësipërme, numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është më i ulët në raport me kapacitetet akomoduese që këto kopshte posedojnë. Në kopshtet e qendrës së qytetit të Korçës numri i fëmijëve të regjistruar është brenda kapaciteteve të duhura ndërsa në kopshtet pranë njësive administrative kemi numër më të vogël se standarti.

Në Bashkinë e Korçës ka 48 kopshte publike, nga të cilat; 13 kopshte në qytet, 29 kopshte në NJA dhe 6 klasa përgatitore. 27 kopshte në NJA dhe 6 klasa përgatitore në qytet, ndodhen brenda godinave të shkollave.

Numri më i lartë i regjistrimeve është në kopshtet e Qytetit të Korçës **1011 fëmijë nga të cilët 519 femra.**

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopsht

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Regjistrimi i fëmijëve në kopshte sipas kapaciteteve akomodues
2	Respektimi i standardeve për sa i përket numrit të fëmijëve në grupe
3	Parashikimi dhe projeksionimi i numrit të fëmijëve që do regjistrohen në kopshte në planin 3-vjecar
4	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale
5	Rritja e cilësisë në administrimin dhe monitorimin e kopshteve nëpërmjet ndërtimit të instrumentave teknologjikë.
6	Rritja e menaxhimit dhe monitorimit të kopshteve pranë NJA-ve që ndodhen brenda godinave të shkollave (33), të cilat aktualisht menaxhohen nga drejtorët e shkollave

Indikatorët e performancës

Ko di	Indikatori	Shpërnda rjagjeografike	Matje ne:	Agregimi	FaktA ktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Fshat	Vlerë	Shumatore	406	406	400	400
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Qytet	Vlerë	Shumatore	1120	1120	1080	1070
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Fshat	Vlerë	Mesatare	3	4	4	4
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Qytet	Vlerë	Mesatare	4	5	5	5
002	Norma e regjistrimit në kopsht (mbi bazen e te dhenave te konsultores)	Fshat	%	Tjetër	75	75	80	85
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Qytet	%	Tjetër	75	75	80	85
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Fshat	Vlerë	Shumatore	406	406	400	400
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Qytet	Vlerë	Shumatore	1120	1120	1080	1070
010	Numri i punonjësve në Njësinë që menaxhon arsimin parashkollor brenda Bashkisë	Bashki	Vlerë	Shumatore	25	25	25	25

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	FaktAktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2025	Total periodhe
007	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	4-5	0	0	0	0
005	Regjistrimi në kopsht sipas banimit	Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	75%-85%	0	0	0	0
004	Vlerësimi i brendshëm i kopshteve (Vlerësimi i brendshëm draft, pritjet miratimi në nivel qendror)	Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	1	0	0	0	0
003	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	48	0	0	0	0
002	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti (konsultore + GJC)	Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	1 herë në vit	0	0	0	0
001	Fuqizimi i strukturës përgjegjëse	Këshilltarja për Arsimin Parashkollor	1	765.6	765.6	765.6	2296.8

Numri	Projekti	Pergjegjes	FaktAktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2025	Total periudhe
	për arsimin parashkollor	në Bashkinë Korçë					
006	Fuqizimi i strukturës përgjegjëse për arsimin parashkollor	Psikolog per Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	1	765.6	765.6	765.6	2296.8

Lista e projekteve

Nr. 001	Projekti: Fuqizimi i strukturës përgjegjëse për arsimin parashkollor	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
I Situata: Bashkia Korçë që prej 2020 ka përfshirë në strukturën drejtuese të këtij institucioni personin përgjegjës për arsimin parashkollor, i cili menaxhon ecurinë e këtij shërbimi.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Ka lindur nevoja për zgjerimin në një strukturë të plotë për menaxhimin sa më të mirë të shërbimit.		
ii Synimi i projektit		
Synimi i këtij projekti është konsolidimi dhe zgjerimi i strukturës së bashkisë e cila është përgjegjëse për menaxhimin e arsimit parashkollor.		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
1. Miratimi i strukturës së zgjeruar të Arsimit parashkollor, brenda strukturës së bashkisë.		

B: Menaxheriale

1. Trajnimi i punonjësve të rinj që do të jenë pjesë e strukturës për përgjegjësitë dhe njohja me kontekstin e bashkisë dhe situatën aktuale të arsimit parashkollor.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Miratimi i buxhetit për punonjësit shtesë. Paga e punonjësit = 765.6 (mijë lekë)
2. Trajnimi i punonjësve të rinj që do të jenë pjesë e strukturës për përgjegjësitë dhe njohja me kontekstin e bashkisë dhe situatën aktuale të arsimit parashkollor.

Pagat janë bazuar në Urdhrin e Bashkisë Korçë, "Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2023".

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të kopshteve;
2. Ofrimi i shërbimit psiko-social për fëmijët në moshë kopshti nga bashkia;
3. Rritja e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Kryetari i Bashkisë
- Keshilltarja e Kryetarit të Bashkisë për Arsimin Parashkollor
- NShMAÇ

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Miratimi i strukturës dhe buxhetit në KB (psikolog+punonjës social)	Kabineti i Kryetarit të bashkisë	1	765.6	765.6	765.6	2296.8
	Miratimi i strukturës dhe	Bashki	1	765.6	765.6	765.6	2296.8

	buxhetit në KB (psikolog)						
	Miratimi i strukturës dhe buxhetit në KB (punonjës social)	Bashki	0	0	0	765.6	765.6
2	Trajnimi i punonjësve të rinj për përgjegjësi dhe njohja me kontekstin e bashkisë dhe situatës aktuale të arsimit parashkollor.	Kabineti i Kryetarit të bashkisë	2	3	3	4	10
				1531.2	1531.2	2296.8	5359.2
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Kabineti i Kryetarit të bashkisë dhe NSHMAÇ			

Nr. 002	Projekti: Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
I Situata		
Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, disponon një listë të fëmijëve në moshë kopshti e cila është siguruar nga Konsultoret e fëmijëve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Mungesa e nje database zyrtare për numrin e fëmijëve 3-6 vjeç e cila të shërbejë si pikë referimi për regjistrimet e fëmijëve në kopshte.		
Regjistrimi i fëmijëve në kopshte sipas rajoneve ku banojnë.		

Regjistrimi dhe frekuentimi në kopsht nuk janë të detyrueshëm, megjithatë arsimit parashkollor është shumë i rëndësishëm për formimin e fëmijëve. Ka dale si nevojë llogaritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në moshë kopshti dhe po punohet për të rritur atë.

Në kopshtet periferike të qytetit të Korçës dhe në disa njësi administrative, numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është më i ulët në raport me kapacitetet që këto kopshte disponojnë. Ndërsa, në kopshtet pranë qendrës së qytetit të Korçës numri i fëmijëve të regjistruar është në ose mbi kapacitetin. Si rezultat i analizës së numrit të fëmijëve të regjistruar në raport me kapacitetet pritëse të kopshteve, në kopshtet e Bashkisë Korçë norma e regjistrimit në raport me kapacitetin është 75%, ndërsa kemi edhe 25% vende vakante në raport me kapacitetin.

ii Synimi i projektit

Një mënyrë për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti në Bashki synon të ngrejë bashkëpunimin ndërinstitucional me Zyrën e Gjendjes Civile dhe Qendrat Shëndetësore. Bashkëpunimi me Zyrën e Gjendjes Civile do të mundësojë listën e fëmijëve të regjistruar në Gjendje Civile të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nga Qendrat Shëndetësore mund të merren listat e fëmijëve të vaksinuar të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nëpërmjet këtij projekti synohet që:

1. Rritja e regjistrimit dhe frekuentimit të kopshtit nga fëmijët.

Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, pas përfundimit të regjistrimit të fëmijëve, mund të identifikojë fëmijët në moshë kopshti që nuk janë regjistruar. Në këtë mënyrë, drejtorët dhe mësueset e kopshteve mund të kryejnë takime me prindërit për të kuptuar arsyet e mosregjistrimit të fëmijëve të tyre në kopsht dhe informimin mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmijëve. Në këtë mënyrë, synohet të rritet numri i fëmijëve që regjistrohen dhe ndjekin kopshtin.

2. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit.

Duke pasur listat e fëmijëve në moshë kopshti sipas vendbanimit dhe moshës, personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, mund ta ketë më të lehtë të marrë vendimin për regjistrimin ose jo të fëmijëve në kopshtet ku kanë aplikuar.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Përcaktimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për dërgimin e listave të fëmijëve në moshë kopshti mes:

- Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

- Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore.

Marrëveshja do të përmbajë karakteristikat e listës që nevojitet (emri i fëmijëve, ditëlindja, vendbanimi), afatet e përgatitjes dhe dërgimit të saj, zyra/personi përgjegjës i secilit institucion për mbulimin e detyrimeve sipas marrëveshjes dhe mënyrën e dërgimit të listave.

B: Menaxheriale

1. Përcaktimi i një personi/zyre përgjegjëse nga secili institucion për dërgimin/marrjen e listave sipas rregullave të marrëveshjes së firmosur.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes mes Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore;
2. Zbatimi i marrëveshjes. Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, merr listat dhe harton një listë të unifikuar të fëmijëve në moshë kopshti.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Listë vjetore të fëmijëve në moshë kopshti;
2. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve sipas zonave të banimit;
3. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;
4. Mundësia e projeksionit të regjistrimit të fëmijëve në plan 3-vjeçar.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë,

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Gjendja Civile e Korçës
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- Drejtoria e Shendetit Publik Korçë

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi dhe firmosja e	Zëvendeskryetare e Bashkisë	2	0	0	0	0

	marrëveshjeve	Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë,					
3	Zbatimi i marrëveshjes	Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	2	0	0	0	0
			2	0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026			g) Ndjek zbatimin e projektit: Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë				

Nr. 003	Projekti: Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
I Situata Kopshtet në Bashkinë Korçë hartojnë dhe zbatojnë planin afatmesëm. Plani Afatmesëm përmban: <ul style="list-style-type: none"> • Misionin; • Vizionin; • Analiza e gjendjes; • Përparësitë; • Veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive; • Produkti ose treguesit e arritjeve; • Buxheti i përafërt. 		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		

Në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 “Përmiratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet kompetenca e hartimit të Planit Afatmesëm të IA dhe rubrikat e tij. Sipas tij, detyrën për ngritjen e grupit të punës nga mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore (me kryetar drejtuesin e kopshtit) për hartimin e planit afatmesëm e ka drejtuesi i kopshtit. Ky urdhër zbatohet nga kopshtet e bashkisë Korçë.

ii Synimi i projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e kapaciteteve në lidhje me hartimin, monitorimin dhe përmirësimin e planit afatmesëm në të gjithë kopshtet e Bashkisë Korçë.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Trainimi i vazhduar i drejtuesve të kopshteve për hartimin e planit afatmesëm;
2. Zbatimi i Urdhrit nr. 31, neni 49 dhe 50 për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm në të gjitha kopshtet e Bashkisë Korçë.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Trainimi i vazhduar drejtuesve të kopshteve/përgjegjësve të kopshteve për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm.
2. Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kopshtet vendosin vetë objektiva dhe i arrijnë ato;
2. Kopshtet funksionojnë jo vetëm si institucione në varësi të Bashkisë, por kanë edhe plane dhe objektiva të vetat që nxisin zhvillimin më të shpejtë të tyre.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Trainimi i drejtuesve të kopshteve/ mësuesve përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm	Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	2	0	0	0	0
2	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht	Drejtuesit/Përgjegjësit e kopshteve	48	0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026			g) Ndjek zbatimin e projektit: Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë				

Nr. 004	Projekti: Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
I Situata Është draftuar në nivel qendror “Metodologjia e realizimit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”. Bashkia Korçë do të punojë për të zbatuar këtë metodologji sapo ajo të jetë zyrtarizuar. Vlerësimi i brendshëm ka si synim të analizojë pikat e forta, mundësitë për përmirësime dhe faktorët që kanë favorizuar ose penguar cilësinë. Vetëvlerësimi, në asnjë rrethanë, nuk duhet të		

bëhet qëllim në vetvete. Ai bëhet shumë më i fuqishëm, kur rezultatet transformohen në një plan zhvillimi.

Plani do të identifikojë fusha dhe probleme që kërkojnë ndryshim dhe zgjidhje të reja, gjithashtu, do të identifikojë edhe objektivat, procedurat, burimet njerëzore dhe financiare për procesin e ndryshimit.

Qëllimi i metodologjisë së vlerësimit të brendshëm është të drejtojë, të orientojë, të lehtësojë mësuesit, organizmat kolegjalë të kopshtit, drejtuesit e kopshtit, për të vlerësuar veten, me qëllim ndërjegjësimin e të gjithëve aktorëve të kopshtit, sepse ata janë forca më e qenësishme, më e qëndrueshme e ndryshimit për përmirësimin e kopshtit.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 “*Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”, vlerësimi i brendshëm:

1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;
2. kryhet çdo vit;
3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi IA-së;
4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmesh.

ii Synimi i projektit

Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikua për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Zbatimi i “Metodologjia e realizimit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”
2. Zbatimi i Urdhrit nga Kryetari i Bashkisë, për realizimin e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshtit.

B: Menaxheriale

<ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për vlerësimin e brendshëm bazuar mbi “Metodologjia e realizimit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit” 2. Drejtuesit e kopshteve trajnojnë stafin arsimor të kopshtit dhe organizmat e kopshtit (Këshillin, Bordin dhe Komisionin) për kryerjen e vlerësimit të brendshëm; 3. Drejtuesi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël të masash ose aspektesh që lidhen me kopshtin. Fokus grupi zhvillohet në periudhën kohore të pranuar nga të gjithë anëtarët dhe ka 6-8 pjesëmarrës; 4. Koordinator i grupit, harton analizën përmbledhëse të vlerësimit të brendshëm. 5. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve vjetore. 	
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve. 2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm. 3. Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshteve; 4. Organizimi i fokus grupeve; 5. Analiza dhe raportimi i rezultateve. 	
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshteve nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve duke krijuar disa indikatorë të matshëm; 2. Nxitja për vet-përmirësimin e mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve; 3. Planifikimi objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm. 	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • ZVAP • MAS • ASCAP
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>	

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve	Bashkia	1	0	0	0	0
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	ASCAP	2	0	0	0	0
3	Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit	3	0	0	0	0
4	Organizimi i fokus grupeve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit	3	0	0	0	0
5	Analiza dhe raportimi i rezultateve	Koordinator i Grupit dhe ZVAP	1	0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë			

Nr. 005	Projekti: Regjistrimi në kopsht sipas zonës së banimit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>I Situata</p> <p>Aplikimet për regjistrimin e fëmijëve bëhen pranë kopshteve nga prindërit. Dokumentet për aplikim janë: certifikata familjare, certifikata e banimit dhe për kopshtin me ushqim kërkohet edhe vërtetim pune për njërin nga prindërit. Dokumentet shqyrtohen nga një grup pune në përbërje të të cilit ka mësuese, drejtuese kopshtesh dhe Personi përgjegjës për arsimin parashkollor në bashki, të cilat krijojnë edhe dosjet individuale për çdo fëmijë.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Shpërndarja jo e barabartë e fëmijëve në kopshte shkakton pengesa në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve.		
<p>ii Synimi i projektit</p> <p>Për të siguruar shpërndarjen e barabartë të fëmijëve në kopshte është e rëndësishme të sigurohet që cilësia e shërbimit në të gjithë kopshtet është e njëjtë dhe regjistrimi kryhet sipas zonës së banimit dhe jo sipas preferencave të prindërve. Ky projekt përqendrohet në realizimin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit.</p>		
<p>iii Niveli i ndërhyrjes</p> <p>A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatimi I PSV “Regjistrimi i femijeve në kopësht” (miratuar në Qershor 2021) që përcakton aktorët përgjegjës, afatet kohore dhe mënyrën e ndërveprimit ndërmjet palëve gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë <p>B: Menaxheriale</p> <p>Zbatimi i PSV “Regjistrimi i fëmijëve në kopësht”</p>		
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatimi i PSV “Regjistrimi i fëmijëve në kopësht” 2. Zbatimi i hapave mbi procedurën e regjistrimit; 3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit; 4. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht; 		

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit;
2. Shpërndarje e njejtë e regjistrimit të fëmijëve;
3. Rritje e numrit të regjistrimeve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brendabashkisë)

- Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë
- Drejtuese të kopshteve, mësuese të kopshteve

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
2	Zbatimi i hapave per procedurën e regjistrimit	Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	Zbatohet rajonizimi për regjistrimin	0	0	0	0
3	Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit	Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	Realizohet shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit	0	0	0	0
4	Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht	Përsioni përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë Zyra e GJC, Konsultoret e femijeve, Drejtoret e kopshteve	Realizohet pjesërisht	0	0	0	0
				0	0	0	0

f) Periudha e zbatimit: 2024-2026	g) Ndjek zbatimin e projektit: Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce
---	---

Nr. 006	Projekti: Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
---------	--	--

a)Përshkrim i shkurtër i projektit

I Situata

Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor, ka shënuar rritje dhe po ndikon në mirefunksionimin e aktivitetit të institucioneve parashkollore.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Rritja e përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje dhe aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor

ii Synimi i projektit

Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve, e pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve të arsimit parashkollor.

Nëpërmjet aktiviteteve synohet:

1. **Zhvillimi i fëmijëve.** Në këto aktivitete, protagonistët kryesorë do të jenë fëmijët, duke recituar, treguar përralla, kërcyer, etj. Në këtë mënyrë, aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar dhe mësuar gjëra të reja do të rriten;
2. **Informimi i komunitetit.** Këto aktivitete është mirë që të ndërthuren dhe me sesione të shkurtra informuese për rëndësinë që ka arsimi parashkollor te formimi i fëmijëve ose të jenë kryesisht me natyrë informuese. Përveç aktivizimit të fëmijëve, komuniteti do të njihet, nëpërmjet mësuesëve, edhe me faktin se sa i rëndësishëm është arsimi dhe nevojën që ekziston që ky komunitet të jetë më aktiv në çështje të arsimit parashkollor. Në këtë mënyrë, mund të llobohet prej tyre gjatë hartimit të buxhetit në Bashki për të rritur buxhetin e vendosur për kopshtet;

3. **Rritja e regjistrimeve.** Njëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga kopshti, prinderit do të njihen me ambientet, mësueset, mënyrat e mësimdhënies, përfitimet e fëmijës nga kopshti dhe në këtë mënyrë synohet të rritet norma e regjistrimit;

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

B: Menaxheriale

1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikojnë aktivitetet.
2. Kalendari i aktiviteteve dërgohet tek Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë

C:Infrastrukturore

iv Aktivitetet kryesore të projektit

Shtator	Tetor-Dhjetor	Janar-Mars (vetëm për kopshtet e NJA)	Prill-Gusht(vetëm për kopshtet e NJA)
Prindërit dhe mësuesit takohen për të diskutuar: 1. Aktivitetet që do realizohen gjatë vitit; 2. Nevojat që kanë fëmijët dhe komuniteti; 3. Kopshti rrit formimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Prindërve.	Kopshti: -Planifikon aktivitetet bazuar te nevojat e fëmijëve dhe komunitetit. Prindërit: -Marrin pjesë tek aktivitetet që ata kanë shprehur dëshirën të jenë pjesëmarrës; -Informohen nga kopshti në mënyrë të vazhdueshme për planin që zhvillon kopshti.	Në bashkëpunim me kopshtin dhe bashkinë, organizohen takime me komunitetin. Komuniteti merr pjesë në organizimin e aktiviteteve të ardhshme.	-Kopshti ofron aktivitete në ambient të hapur; -Komuniteti mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete; -Prindërit ndihmojnë fëmijën në ndjekjen e detyrave.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht;

2. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre.							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë 				<ul style="list-style-type: none"> Komuniteti Kopshti Universiteti “Fan S. Noli” 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve	Drejtuesi/Përgjegjës i kopshtit	48	0	0	0	0
2	Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit	48	0	0	0	0
3	Takim me Këshillin e Prindërve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit	48	0	0	0	0
4	Organizimi i aktiviteteve	Drejtuesi/Përgjegjës i kopshtit	48	0	0	0	0
			48	0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë			

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Këshilli i Prindërve

Informacion i përgjithshëm

Bazuar në Urdhrin Nr. 31, dt.28/01/2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", kopshtet krijojnë Këshillin e Prindërve.

Urdhri Nr. 31, dt.28/01/2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë".

- **Neni 89/pika 4:** Këshilli i Prindërve të institucionit përbëhet nga 6-9 prindër të zgjedhur nga këshillat e klasave. Numri i prindërve në këshillin e prindërve përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit arsimor. Në mbledhjen e parë të këshillit, kryetari i tij zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të këshillit, midis kandidatëve për këtë detyrë. Neni 89/pika 6: Kryetari dhe anëtarët e këshillit të prindërve nuk duhet të jenë në konflikt interesi me drejtorin e institucionit, nuk duhet të kenë precedentë penalë dhe të mos jenë në forume të partive politike.
- **Neni 90:** Mbledhjet dhe vendimet e këshillit të prindërve të institucionit arsimor. **90/pika 1:** Këshilli i prindërve mbledhet të paktën tre herë në vit. Mbledhje të tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të këshillit të prindërve ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. **90/pika 2:** Mbledhja e këshillit zhvillohet kur merr pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të tij, përndryshe shtyhet.
- **Neni 92/pika 2:** Këshilli i prindërve të klasës zgjidhet për çdo klasë, brenda 10 ditëve, nga data e fillimit të vitit shkollor, me përkujdesjen e mësuesit kujdestar. Për këtë zhvillohet mbledhja e përgjithshme e prindërve të nxënësve të klasës, ku me shumicë votash zgjidhet këshilli i prindërve të klasës (3-5 persona). Kryetari i këshillit të prindërve të klasës zgjidhet nga ky këshill.

Këshilli i Prindërve ngrihet çdo fillim viti me urdhër të drejtuesit/përgjegjësit të kopshtit. Këshilli i Prindërve të kopshtit nuk monitorohet nga Bashkia por vetëm nga drejtuesi/përgjegjësi i kopshtit.

Objektiva kryesore:

Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet sipas Udhëzimit Nr. 31
2	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve në menaxhimin e kopshtit

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Viti 2024	Plan Viti 2025	Plan Viti 2026
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Fshat	Vlerë	Mesatare	3	3	3	3
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Qytet	Vlerë	Mesatare	3	3	3	3
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlerë	Mesatare	3	3	3	3
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Qytet	Vlerë	Mesatare	4	4	4	4
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë	Fshat	Vlerë	Mesatare	3	3	3	3
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i	Qytet	Vlerë	Mesatare	4	4	4	4

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Viti 2024	Plan Viti 2025	Plan Viti 2026
	Prindërve ka marrë pjesë							
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlerë	Mesatare	4	4	4	4
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Qytet	Vlerë	Mesatare	5	5	5	5
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlerë	Shumator e	29	29	29	29
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Qytet	Vlerë	Shumator e	19	19	19	19

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxhet Viti 2024	Buxhet Viti 2025	Buxhet Viti 2026	Total periudhë
008	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	48	0	0	0	0
007	Themelimi i Këshillit të Prindërve	Personi përgjegjës për Arsimin	48	0	0	0	0

Numri	Projekti	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxhet Viti 2024	Buxhet Viti 2025	Buxhet Viti 2026	Total periudhë
		Parashkollor në Bashkinë Korçë					

Listat e projekteve

Nr. 007	Projekti: Themelimi i Këshillit të Prindërve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
I Situata Gjatë analizës së arsimit parashkollor në Bashkinë e Korçës rezulton që janë ngritur këshillat e prindërve në kopshtet në qytet (13) dhe në NJA.(29)		
ii Synimi i projektit Nëpërmjet këtij projekti synohet: <ol style="list-style-type: none"> 1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht dhe ndarja e tij nga Këshilli i Shkollës; 2. Rritja e pjesëmarrjes së prindërve në Këshillat e Prindërve. Sipas Udhëzimit nr. 31 		
iii Niveli i ndërhyrjes A: Ligjore B: Menaxheriale <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopshtet themelojnë Këshillin e Prindërve dhe i dërgojnë listën e anëtarëve Këshilltares për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë sipas Udhëzimit nr. 31; 2. Kopshtet që ndodhen në godinat e Shkollave themelojnë Këshillin e Prindërve të mëvetësishëm nga Këshilli i Prindërve të Shkollës; 		

<p>3. Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, Drejtoret e kopshteve monitorojnë procesin e themelimit të Këshillave të Prindërve për të siguruar që çdo kopsht i përmbahet Udhëzimit nr. 31.</p>							
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht; Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve. 							
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <ol style="list-style-type: none"> Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 31. 							
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Personi përgjegjës për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë 				<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p>			
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>							
Nr	Emertimi	Përgjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht	Drejtuesit/përgjegjës të kopshteve	48	0	0	0	0
2	Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, Drejtoret e kopshteve	48	0	0	0	0
			48	0	0	0	0
<p>f) Periudha e zbatimit: 2024-2026</p>				<p>g) Ndjek zbatimin e projektit:</p>			

Stafi i kopshteve informohet vazhdimisht për mënyrën e identifikimit dhe raportimit të rasteve të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje që frekuentojnë kopshtin, ai ndjek rastet e fëmijëve të regjistruar në kopsht që janë identifikuar dhe ndiqen nga PMF.

ii Synimi i projektit

Për të rritur numrin e fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe për të siguruar trajtimin e çështjes së tyre në mënyrë efikase, e stafi i kopshtit njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe vendoset një person kontakti në çdo kopsht, që do të jetë përgjegjës për zbatimin e saj (për tu njohur me kanalet e raportimit dhe identifikimit dhe përgjegjësitë që ju takon sipas ligjit).

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Në çdo kopsht vendoset personi i kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve;
2. Të dhënat e tyre ndahen me strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.
3. Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopsht bëhet pjesë e mekanizmit të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve;
4. Roli i këtij personi është të shërbejë si një pikë kontakti dhe të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë stafet në kopshte dhe çerdhe në zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve;
5. Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopsht është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes në lidhje me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve;
6. Bashkia vë në dispozicion të kopshteve informacion të vazhdueshëm dhe profesional për mbrojtjen fëmijëve.
7. Organizimi i trainimeve të veçanta për Personat e Kontaktit për të rritur kapacitetet e tyre mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve. Trainimet organizohen nga PMF.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Përcaktimi i Personit të Kontaktit
2. Dërgimi i të dhënave të Personit të Kontaktit në NJMF në Bashki dhe PMF në NJA;
3. Organizimi i trainimit të Personave të Kontaktit nga drejtuesit e kopshteve (të trajnuar më parë nga NJMF) për rritjen e kapaciteteve mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritja e numrit të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje.
2. Rritje e kapaciteteve të stafit të kopshteve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.
3. Menaxhimi efikas i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brendabashkisë)

- Drejtoria e Kujdesit Social (NJMF, PMF)
- Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Përcaktimi i Personit të Kontaktit	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	48	0	0	0	0
2	Dërgimi i të dhënave të NJMF	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	48	0	0	0	0
3	Trainimi i Personave të Kontaktit	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	48	0	0	0	0
			48	0	0	0	0

f) Periudha e zbatimit:

g) Ndjek zbatimin e projektit:

2024-2026	Përgjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë
-----------	--

Nr. 016	Projekti: Shtimi i psikologëve në strukturën e arsimit parashkollor	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
I Situata		
Në Bashkinë e Korçë është emruar një psikolog për arsimin parashkollor.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevojë për ndërhyrje		
Duke i dhënë fokus trajtimit të problematikave psikosociale të fëmijëve në moshë kopshti, është e nevojshme të ketë punonjës të dedikuar për trajtimin e tyre në strukturën e Arsimit parashkollor.		
ii Synimi i projektit		
Nëpërmjet punësimit të 1 psikologu të dedikuar për fëmijet në moshë kopshti do të trajtohen më mirë problematikat psiko-sociale të fëmijëve.		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ofrohet shërbim cilësor dhe profesional i dedikuar për fëmijet në moshë kopshti; 2. Mbulim më i mirë i nevojave të fëmijëve që kanë nevojë për trajtim; 3. Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përfshirje sociale. 		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
Pozicioni i psikologut për Strukturën e Arsimit parashkollor është i miratuar.		
B: Menaxheriale		

1. Drejtoria e Kujdesit Social në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse punëson psikologët sipas procedurave të brendshme;
2. Psikologët e dedikuar për kopshtet hartojnë planet e punës, vizitat në terren, këshillimin dhe trajtimin e rsateve të identifikuara të femijeve në nevoje për përfshirje sociale dhe vizita dhe takime me fëmijët e kopshteve për të vlerësuar nevojat e tyre psiko-sociale.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Punësimi i 1 psikologu. Paga për 1 psikolog = 756.5 mijë lekë.
2. Vizita në terren nga psikologu për vlerësimin psiko-social të fëmijëve dhe trajtimin e rsateve të identifikuara të femijeve në nevoje për përfshirje sociale.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritje e numrit të femijeve që marrin shërbime;
2. Rritje e numrit të femijeve të raportuar pranë PMF;
3. Rritje e numrit të femijeve që marrin shërbime të specializuara sipas nevojave;
4. Çdo fëmijë që frekuenton kopshtin dhe merr trajtim psikosocial, ka dosjen e vet individuale, ku perfshihen praktika e vlerësimit dhe planit të ndërhyrjes.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)

- Drejtoria e Kujdesit Social
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
2	Punësimi i 1 psikologu	Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse	1	756.5	756.5	756.5	2269.5

3	Vizita në terren nga psikologu për vlerësimin psiko-social të fëmijëve	Përgjigjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	144	0	0	0	0
				756.5	756.5	756.5	2269.5
f) Periudha e zbatimit:				g) Ndjek zbatimin e projektit:			
2024-2026				Drejtoria Shërbimit Social			

3.4.2 Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës

Informacion i përgjithshëm

Në Bashkinë Korçë, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, është një strukturë e atashuar pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, në përbërje të të cilës është një punonjës për mbrojtjen fëmijëve. Kjo njësi ka si detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e çështjeve të fëmijëve në rrezik dhe/ ose në nevojë për mbrojtje. Pranë Njësive Administrative nuk ka PMF të dedikuar, por ky rol kryhet nga Administratori social.

Në Bashkinë Korçë në total janë të punësuar 7 Administratorë Social, 1 Administrator për Njësi. Në Qytetin e Korçës janë të punësuar 6 Administratorë Social, 1 Administrator për Rajon.

Në Drejtorinë e Shërbimit Social, janë të punësuar 2 punonjës social.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe shërbimi psikosocial janë njësi me shumë rëndësi për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë për kopësht. Është me rëndësi që këto dy struktura të jenë funksionale dhe ndërveprojnë ngushte për çdo fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje që frekuenton kopshtin

Grupi teknik ndërsektorial në qytetin e Korçës për trajtimin e çështjeve të përfshirjes sociale dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje është funksional. Ky grup trajton te gjitha rastet e referuara përfshirë edhe ato të fëmijëve në moshë kopshti. Njësitë Administrative nuk kanë një Grup Teknik Sektorial të mëvetësishëm. Kur një çështje e një fëmijë që jeton në NJA ka nevojë për mbledhjen e GTN, atëherë mbledhet GTN e qytetit të Korçës, por me drejtimin e Administratorit shoqëror të NJA përkatëse.

Objektiva kryesore:

Shërbimi cilësor në kopsht që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo kohë, jo vetëm gjatë raportimit, por përgjatë gjithë kohë së qëndrimit në kopsht të fëmijës.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpëmjet GTN (grupeve teknike ndërsektoriale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre
2	Fuqizimi i rrejtit të punonjësve dedikuar mbrojtjes së fëmijëve

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
044	Fëmijë në nevojë për mbrojtje që kanë marrë shërbimin e psikologut (%)	Fshat	%	Funksion i drejtorise se kujdesit social	2	2	2	2
044	Fëmijë në nevojë për mbrojtje që kanë marrë shërbimin e psikologut (%)	Qytet	%	Funksion i drejtorisë së kujdesit social	10			
046	PIM të hartuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje ndaj numrit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (%)	Fshat	%	Funksion i drejtorise se kujdesit social	2			
046	PIM të hartuara për femijet në nevoje për mbrojtje ndaj	Qytet	%	Tjeter	10			

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	numrit të femijeve në nevoje për mbrojtje (%)							
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Fshat	Vlerë	Mesatare	36	36	36	36
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Qytet	Vlerë	Mesatare	105	105	105	105

3.5 Fëmijët me aftësi ndryshe

3.5.1 Adresimi i prindërve

Informacion i përgjithshëm

Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuara. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.

Qëndresa që bëjnë prindërit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi ndryshe vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjate procesit të diagnostikimit të fëmijës nëpërmjet trajnimit të stafit të kopshteve dhe ofrimit të shërbimit psiko-social për prindërit

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
047	Numri i fëmijëve me AK të diagnostikuar këtë vit	Qytet	Vlerë	Shumatore	15	15	15	15
047	Numri i fëmijëve me AK të diagnostikuar këtë vit	Fshat	Vlerë	Shumatore	0	0	0	0
048	Fëmijë me AK që janë diagnostikuar pas dyshimit të stafit të kopshtit (%)	Qytet	%	Tjetër	13%	13%	13%	13%
048	Fëmijë me AK që janë diagnostikuar pas dyshimit të stafit të kopshtit (%)	Fshat	%	Tjetër	0	0	0	0
049	Numri i fëmijëve me AK në total	Qytet	Vlerë	Shumatore	15	15	15	15
049	Numri i fëmijëve me AK në total	Fshat	Vlerë	Shumatore	0	0	0	0

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
018	Përmirësimi i procesit të diagnostifikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë /Drejtorja e kujdesit Social	6	2460	2460	2460	7380

Lista e projekteve

Nr. 017	Projekti: Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve	Programi Buxhetor: 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
iSituata		
Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin probleme me prinderit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuara. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Qëndresa që bëjnë prinderit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë..		
ii Synimi i projektit		

Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimin e specializuar të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe asistimin e mesuesve gjatë procesit të komunikimit me prindërit.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

- 1) Shtimi i numrit të mësuesve ndihmës në arsimin parashkollor

B: Menaxheriale

- 2) Hartimi i planit të trainimit të mësuesve të arsimit parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind nga psikologët e stafit të Qendres së Aftësisë së Kufizuar. Trainimet mund të organizohen në nivel Njësie Administrative për mësuesit që punojnë në kopshtet që ndodhen në zonat rurale dhe në nivel rajoni për mësuesit e kopshteve që ndodhen në qytetin e Korces. Njëkëtëmënyrë do të organizohen 7 trajnime:
 - a) Në Njësinë Administrative Bulgarec;
 - b) Në Njësinë Administrative Drenovë;
 - c) Në Njësinë Administrative Mollaj;
 - d) Në qytetin e Korçës;
 - e) Në Njësinë Administrative Vithkuq;
 - f) Në Njësinë Administrative Voskop;
 - g) Në Njësinë Administrative Voskopojë;
- 3) Trajnimet e organizuara në qytet nuk kanë kosto.
- 4) Organizim i trajnimeve për mësuesit e arsimit parashkollor nga psikologu e Qendra e Aftësisë së Kufizuar mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind;
- 5) Mësuesi njofton Qendra e Aftësisë së Kufizuar mbi mënyrat në rast se has një problem me prindërit për sa i përket diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- 6) Qendra e Aftësisë së Kufizuar mbi mënyrat vënë dispozicion një psikolog për të trajtuar problematikën e raportuar, duke komunikuar me prindërit dhe mësuesin.
- 7) Do të vihen në funksion të përmirësimit të procesit të diagnostikimit të fëmijëve edhe 5 punonjës të Qendrës së Fëmijëve me Aftësi Ndryshe.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit;
2. Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind.
3. Ofrimi i shërbimit psiko-social për prindërit që kanë vështirësi për të pranuar se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Përshejtim i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë • Drejtoria e Kujdesit Social. 				OJF			
				ASCAP			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit	Drejtuesit e kopshteve	48	0	0	0	0
3	Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	3	0	0	0	0
4	Ofrimi I shërbimit psiko-social për prindërit	Drejtueset e kopshteve	9	0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë			

3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë

Informacion i përgjithshëm

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopsht është 15. Infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në disa nga ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.

Objektiva kryesore:

Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Heqja e barrierave që pengojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me AK në kopshte

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje në:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
055	Kopshte që kanë rampa (%)	Qytet	%	Tjeter	60%	60%	70%	80%
055	Kopshte që kanë rampa (%)	Fshat	%	Tjeter	40%	40%	50%	60%

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	FaktAktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
019	Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	NSHMAC	55%	50	50	50	150

Listae projekteve

<p>Nr. 018</p>	<p>Projekti: Vendosija e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore</p>	<p>Programi Buxhetor: 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</p> <p>Funksioni: 09</p>
<p>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</p>		
<p>iSituata</p> <p>Në Bashkinë e Korçës numri i fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të regjistruar në kopsht është 15 fëmijë. Bashkia nuk ka informacion për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në moshë kopshti.</p>		
<p>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</p>		
<p>Ndërkohë që numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në kopsht është 15, infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuar. Në disa nga ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.</p>		
<p>ii Synimi i projektit</p>		
<p>Synimi i këtij projekti është pajisja e gjithë ndërtesave të kopshteve me rampa për të lehtësuar aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar në kopsht..</p> <p>Në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, përcaktohen masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturale për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.</p>		
<p>iii Niveli i ndërhyrjes</p>		
<p>A: Ligjore</p> <p>Miratiminë KB i buxhetit të NSHMAC ku përfshihet edhe vendosja e rampave në kopshte;</p> <p>B: Menaxheriale</p> <ol style="list-style-type: none"> Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave në kopshte nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me NSHMAC. 		

<p>Plani do të përmbajë shtrirjen kohore të ndërhyrjes, kopshtet që do të vendosen rampa çdo vit dhe kostot;</p> <p>2. Hapja e procedurës së prokurimit public për gjetjen e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave.</p>	
<p>C:Infrastrukturore</p> <p>1. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik.</p> <p>2. Meremetim/rikonstruksion/ndërtim</p>	
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <p>1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave në kopshte nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me NSHMAC</p> <p>2. Miratiminë KB i buxhetit të NSHMAC</p> <p>3. Hapja e procedurës së prokurimit publik dhe gjetja e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave;</p> <p>4. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik.</p> <p>5. Meremetim/rikonstruksion/ndërtim</p>	
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <p>1. 75% e kopshteve kanë rampa në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të aksesojnë lehtësisht kopshtin.</p>	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësjë për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë • NSHMAC • Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • OJF • Operatoret ekonomike
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>	

N r	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit	NSHMAC Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit tezhvillimit te territorit	1	0	0	0	0
2	Miratimi në KB i buxhetit	NSHMAC	1	0	0	0	0
3	Hapja e procedurës së prokurimit publik dhe gjetja e operatorit ekonomik	NSHMAC	1	0	0	0	0
4	Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik	Operatori/ët ekonomik		50	50	50	150
				50	50	50	150
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: <ul style="list-style-type: none"> Përgjigjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë NSHMAC 			

Risqet

3.5.3 Ndhma e përditshme

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë së Korçës janë regjistruar 15 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në këtë bashki shërbejnë 3 mësuese ndihmëse.

Për herë të parë, gjatë vitit 2020, Bashkia Korçë krijoi strukturën për mësues ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe të cilat punësohen sipas nevojave të përvitshme në kopshte.

4. Proceset Mbështetëse- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

4.1 Qëllimi

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden Brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar në aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës së godinave të kopshteve, formimin dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të arsimit parashkollor si dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve në të gjitha strukturat e arsimit parashkollor në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Korçë.

4.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

4.3 Burimet Njerëzore

4.3.1 Rekrutimi i stafit

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë Korçë janë të punësuar 141 mësues, përfshirë 3 mësuese ndihmëse.

Nëse do të analizojmë numrin e mësuesve për fëmijë, numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është 1526, numri i mësueseve është 141 dhe numri i fëmijëve për mësuese është mesatarisht 11 fëmijë për mësuese.

Ndërkohë përsa i përket përgatitjes profesionale të mësuesve, numri i mësueseve me përvojë pune nga 0 në 10 vite është 23, ndërsa numri i mësueseve me përvojë pune mbi 10 vjet është 118.

Vetëm 13 kopshte që ndodhen në qytet kanë drejtues më vete. 33+2 kopshtet që janë në godinat e shkollave janë nën menaxhimin e drejtuesit të tyre.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kopshteve duke siguruar nivelin e duhur të stafit percaktuar nga aktet ligjore dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Punësimi i drejtorëve të kopshteve për standardin 1 drejtor për 5 grupe

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikator	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Fshat	Vlerë	Mesatare	11.3	11.3	11.3	11.3
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Qytet	Vlerë	Mesatare	11.3	11.3	11.3	11.3
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Qytet	Vlerë	Shumatore	6 (klasa përgatitore)	6	4	2
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Fshat	Vlerë	Shumatore	29	29	20	15
056	Numri i drejtuesve të kopshteve	Fshat	Vlerë	Shumatore	0	0	0	0
056	Numri i drejtuesve të kopshteve	Qytet	Vlerë	Shumatore	9	9	9	9

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
020	Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorive për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	0	0	0	4620	4620

Lista e projekteve

Nr. 019	Projekti: Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Në Bashkinë Korçë 33 kopshte ndodhen në godinat e shkollave dhe drejtohen nga drejtuesit e tyre. Kjo shkakton problematika në menaxhim dhe tejkalim kompetencash të drejtorit të shkollës, pasi nuk është funksioni tij. 13 kopshte në qytetin e Korçës menaxhohen nga 9 drejtoresh.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevojë për ndërhyrje		
<p>Është e nevojshme që të zbatohet Udhëzimi nr. 14/2023, në të cilin specifikohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopshtet me ushqim ose pa ushqim që kanë të paktën 4 grupe të veçanta ose të përziera të kenë një drejtues të institucionit arsimor; 2. Njësitë e vetë qeverisjes vendore, për kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjeçare, mund të emërojnë një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe fëmijësh. 		
ii Synimi i projektit		
<p>Duke vendosur një drejtues për kopshtet e NJA, i cili raporton tek Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë dhe ka si detyrë të vetmëmënaxhimin e kopshteve, synohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhimi më efikas i kopshteve; 2. Nevojat dhe problemet e kopshteve adresohen në kohën e duhur dhe institucionin e duhur, duke marrë zgjidhje më shpejt; 		

<p>3. Lehtësimi i procesit të edukimit, sepse mësueset do të fokusohen vetëm në edukimin dhe menaxhimin e klasës së tyre.</p>	
<p>iii Niveli i ndërhyrjes A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Propozimi në KB për zbatimin e Udhëzimit nr. 14/2023; (ne kuadrin e PBA përkatëse) 2. Miratimi i buxhetit për punësimin e drejtuesve të kopshteve; <p>B: Menaxheriale</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgjigjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë harton planin për punësimin e drejtuesve të rinj: sa drejtues duhen dhe cilët kopshte do të menaxhojnë; 2. NSHMAC i paraqet KB planin; 3. Pas miratimit të planit nga KB dhe nxjerrjes së Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për punësimin e Drejtuesve, fillon procedura e punësimit në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse. 	
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve (sa drejtues, për cilat kopshte dhe kur do punësohen); 2. Propozimi dhe miratimi në KB; 3. Punësimi i drejtuesve të rinj në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse. 	
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhimi efikas i kopshteve; 2. Zgjidhja më e shpejtë e problemeve që mund të ketë çdokopsht; 3. Procesi i nxënies së fëmijëve më efikas. 	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryetari i Bashkisë Korçë • Përgjigjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, • Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse. 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p>
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>	

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve	NSHMAC	0	0	0	0	0
2	Propozimi dhe miratiminë KB	NSHMAC	1	0	0	0	0
3	Punësimi i drejtuesve të rinj	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse/		0	0	4620	4620
			1	0	0	4620	4620
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026			g) Ndjekzbatimin e projektit:				
			<ul style="list-style-type: none"> NSHMAC <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse/</p>				

4.3.2 Trajnimi i stafit

Informacion i përgjithshëm

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka si përgjegjësi rritjen e kapaciteteve të stafit të IA nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme. Për mësuesit e arsimit parashkollor janë 3 trainime vjetore të detyruara.

Objektiva kryesore:

Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Kryerja e tranimeve vjetore akredituese të stafit të kopshteve nga ASCAP
2	Trainimi i stafit të kopshteve për rastet e emergjencave, ndihmën e parë, etj.

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
060	Numri i mësuesve të trajnuar nga OJF të ndryshme	Fshat	Vlerë	Mesatare	36	36	36	36
060	Numri i mësuesve të trajnuar nga OJF të ndryshme	Qytet	Vlerë	Mesatare	105	105	105	105
059	Numri i mësuesve të trajnuar nga universitete të ndryshëm	Fshat	Vlerë	Mesatare	0	20	25	36
059	Numri i mësuesve të trajnuar nga universitete të ndryshëm	Qytet	Vlerë	Mesatare	30	50	70	90
058	Numri i mësuesve të trajnuar pranë ASCAP	Fshat	Vlerë	Mesatare	36	36	36	36
058	Numri i mësuesve të	Qytet	Vlerë	Mesatare	105	105	105	105

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	trajnuar pranë ASCAP							

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
020	Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve	Përgjgjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë,		158	158	158	316
021	Marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale	Përgjgjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë,	1	0	0	0	0

Nr. 020	Projekti: Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
iSituata		
Kopshtet e Bashkisë Korçë nuk kanë dalje emergjence dhe stafi nuk është i përgatitur për mënyrën e reagimit në rastin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe kur mund të jetë e nevojshme dhënia e ndihmës së parë.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevojë për ndërhyrje		

Një nga nevojat e Bashkisë Korçë është rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve. Është e nevojshme që të kryhen trajnime nga Bashkia Korçë për stafin e IA për temat:

1. Ndhima e parë;
2. Reagimi në situatë rreziku të godinave;

ii Synimi i projektit

Ky projekt synon rritjen e kapacitetit të stafit të kopshteve përsa i përket ndihmës së parë dhe reagimit në situatë emergjente.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Bashkia i kërkon Shërbimit Zjarrfikës kryerjen e trajnimeve të stafit të kopshteve për reagimin në situatë zjarri, tërmeti, përmbajtje, etj;
2. Bashkia kontakton me Kryqin e Kuq dega Korçë dhe i kërkon kryerjen e trajnimeve për Ndhimën e Parë për stafin e kopshteve;
3. Organizimi i kalendarit të trajnimeve nga Përgjigjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dega Korçë dhe Shërbimin Zjarrfikës së Korçës për kryerjen e trajnimeve të stafit të kopshteve;
2. Kryerja e trajnimeve për qytetin e Korçës dhe përçdo NJA.

b) Rezultatet që priten (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritje e kapacitetit të stafit të IA;
2. Shmangia e situatave të rrezikut dhe mbrojtja fizike e fëmijëve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)

- Shërbimi Zjarrfikës pranë Bashkisë Korçë
- Përgjigjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë
- NSHMAC

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Korçë

e) Shpenzimet e llogaritura (përçdoaktivitetet më sipër pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dega Korçë dhe Shërbimin Zjarrfikës	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	1	0	0	0	0
2	Kryerja e trajnimeve për qytetin e Korçës dhe për çdo NJA	Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	1	158	158	158	474
				158	158	158	474
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Përgjegjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë			

Nr. 021	Projekti: Marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale	Programi Buxhetor: 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Universiteti “Fan S. Noli” në qytetin e Korçës ofron degë të profilit teknik, ekonomik, human dhe shëndetit publik. Përpos, stafit të universitetit i cili është mjaft i përgatitur, edhe studentët janë nga profile të ndryshme.</p> <p>Gjithashtu, në Bashkinë e Korçës operojnë shumë OJF të cilat kanë si fokus parësor arsimin parashkollor, mbrojtjen e fëmijëve ose përfshirjen e fëmijëve.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoje për ndërhyrje		

Një nga nevojat e Bashkisë Korçë është ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve. Është e nevojshme që të kryhen trajnime nga Bashkia Korçë për stafin e IA, Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit për temat:

1. Mbrojtja e fëmijëve;
2. Ndihma e parë;
3. Reagimi në situatë rreziku të godinave;
4. Të drejtat/detyrat e Këshillit, Bordit dhe Komisionit;
5. Roli i PMF, etj.

ii Synimi i projektit

Synimi i këtij projekti është zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit mes:

1. Bashkisë dhe Universitetit “Fan S. Noli”,
2. Bashkisë dhe OJF tëndryshme (psh, Kryqi i Kuq Shqiptar, Eolrd Vision, Save the Children, etc.).

Synimi i bashkëpunimit është ofrimi i trajnimeve nga këto institucione në mënyrë që të rritet kapaciteti i stafit të kopshteve. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjes synohet që të sigurohet krijimin i një grupi studentësh vullnetarë që mund të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga kopshtet ose të marrin pjesë në organizimin e tyre.

Gjithashtu, për studentët nga profile të ndryshme mund të ofrohen mundësi intershipi pranë kopshteve.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes:
 - Bashkisë dhe Universitetit “Fan S. Noli”;
 - Bashkisë dhe OJF-ve të ndryshme.

B: Menaxheriale

1. Organizimi i takimeve me Universitetin “Fan S. Noli” dhe përfaqësues nga OJF të ndryshme për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimeve;
2. Zbatimi i marrëveshjeve. Përgjegjës për zbatimin e tyre nga ana e Bashkisë është Përgjigjësja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Organizimi i takimeve mes Bashkisë dhe Universitetit.
2. Organizimi i takimeve mes Bashkisë dhe OJF;

b) Rezultatet që priten (shërbimet apo produktet e pritshme)							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve; 2. Ngritja e grupit të vullnetarëve të studentëve pranë Bashkisë çdo vit. 							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë 				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> • Universiteti "Fan S. Noli", • OJF. 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Organizimi i takimeve mes Bashkisë dhe Universitetit	Përgjigjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	2	0	0	0	0
2	Organizimi i takimeve mes Bashkisë dhe OJF	Përgjigjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë	3	0	0	0	0
			5	0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Përgjigjesja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë			

4.4 Menaxhimi I godinave

4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve

Informacion i përgjithshëm

Pjesa më e madhe e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Korçë ndodhen Brenda godinave të shkollave. Nga 43 kopshte publike në total, vetëm 15 prej tyre janë në godinë më vete, përkatësisht në qytetin e Korçës 13 kopshte, në NjA Bulgarec 1 kopsht dhe në NjAVithkuq 1 kopsht.

Ndërhyrjet infrastrukturore të domosdoshme të renditura sipas numrave të kopshteve, dhe nevojat specifike për secilin kopsht.

Ndërhyrjet infrastrukturore të domosdoshme të renditur sipas numrave të kopshteve, dhe nevojat specifike për secilin kopsht.

- Kopshti nr.10 - Rikonstruksion i sistemit te ngrohjes
- Kopshti nr.12 - Rikonstruksion i sistemit te ngrohjes
- Rikonstruksion i kopshtit Mollaj, ndarja e mjediseve të kopshtit nga ai i shkolles. (2500)
- Rikonstruksion i mjediseve të shkollës Demokracia, ku përfshihet klasa përgatitore
- Vendosja e rampave pranë kopshteve sipas standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK.
- Meremetim/rikonstruksion i pjesshëm i objekteve të kopshteve

Objektiva kryesore:

Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur “Standardet e projektimit të kopshteve” si dhe “Kriteret për hapjen dhe mbylljen e kopshteve”.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Rikonstruksioni i pjesshëm/meremetime i godinave të kopshteve të cilat kanë nevojë për rikonstruksion

Indikatorët e performancës

Kod i	Indikator	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
074	Numri i godinave që janë rikonstruktuar	Qytet	Vlerë	Shumator e	19	2	2	2
074	Numri i godinave që janë rikonstruktuar	Fshat	Vlerë	Shumator e	18	3	3	4
073	Numri i godinave që kanë nevojë për rikonstruksion të pjesshëm/meremeti me	Qytet	Vlerë	Shumator e	6	2	2	2

Kod i	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
073	Numri i godinave që kanë nevojë për rikonstruksion të pjesshëm/meremetime	Fshat	Vlerë	Shumator e	10	3	3	4

Shënim: Listat për rikonstruksione të pjesshme/metemetime të kopshteve hartohen dhe miratohen çdo vit në buxhetin përkatës.

Nr. 022	Projekti: Rikonstruksioni i sistemit të ngrohjes në kopshtin 10	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Kopshti Nr. 10 në qytetin e Korçës ka nevojë për rikonstruksion të sistemit te ngrohjes		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
VKM nr. 159, datë 01.03.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Në të paraqiten standardet për godinat e kopshteve në rast se duhet të ndërtohen të reja ose të rikonstruktohen.		
ii Synimi i projektit Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës së godinës së kopshtit nr. 10, bazuar në Standardet e VKM Nr. 159.		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
1. Miratimi i buxhetit për përmirësimin e sistemit të ngrohjes së Kopshtit Nr. 10 në KB.		
B: Menaxheriale		
Përgatitja e planit të përmirësimit të ngrohjes së Kopshtit Nr. 10 nga		
1. NSHMAC		
2. Drejtoria e Kontrollit të Territorit;		

<ol style="list-style-type: none"> 3. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik për gjetjen e operatorit ekonomik për ndërhyrjet në Kopshtin Nr. 10. Gjetja e operatorit dhe firmosja e kontratës; 4. Supervizimi i punimeve në Kopshtin Nr. 10; 5. Kolaudimi i Kopshtit Nr. 10. <p>C: Infrastrukturore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rikonstruksion i sistemit të ngrohjes i kopshtit nr. 10. 																															
